



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

RISHIKIM JAVOR I TREGUT 13 – 17 nëntor 2023

Nxitësit e tregut

Në tregjet financiare ndërkombëtare, u përforcuan pritshmëritë e investitorëve se cikli i shtrëngimit të politikës monetare nga ana e bankave kryesore qendrore ka përfunduar, duke shkaktuar rënie të fuqishme të normës së kthimit (yield-eve) në të dy anët e Atlantikut. Kjo atmosferë e tregut ka ardhur si rezultat i treguesve të çmimeve më të ulëta të publikuara, si dhe treguesve më të dobët në raport me tregun e ShBA-së. Pritshmëritë e tilla të investitorëve u mbështetën edhe nga të dhënat e pafavorshme të PBB-së në Eurozonë.

Në ShBA, norma e inflacionit edhe më tej shënon prirje rënëse, me ç'rast në tetor është ulur nga 3,7% në 3,2% në bazë vjetore, kryesisht për shkak të çmimeve më të ulëta të energjentëve dhe produkteve ushqimore, si dhe kostove më të ulëta për banim. Në të njëjtën kohë, inflacioni bazë është ulur nga 4,1% në 4% në bazë vjetore, kundrejt pritjeve të tregut për normë të pandryshuar. Gjatë muajit të njëjtë, çmimet e importit në ShBA u ulën për 2% në bazë vjetore, duke kontribuar më tej në uljen e presioneve inflacioniste. Në muajin tetor, prodhimi industrial në mënyrë të papritur është ulur për 0,6% në bazë mujore, kryesisht si rezultat i rënies së prodhimit të pjesëve të automjeteve.

Në eurozonë, në pajtim me vlerësimin e dytë, PBB-ja në eurozonë, në tremujorin e tretë është ulur për 0,1% në bazë tremujore, duke mbështetur pritshmëritë se ekonomia mund të hyjë në recesion teknik në tremujorin e katërt. Megjithatë, në ekonominë më të madhe të eurozonës, në Gjermani, treguesi ZEV i pritshmërive afariste është rritur nga -1,1 në 9,8 pikë, që paraqet arritjen e parë pozitive nga prilli e kënde, duke vënë në dukje se investitorët presin përmirësim të aktivitetit ekonomik në Gjermani në gjashtë muajt e ardhshëm. Në lidhje me treguesit e publikuar të çmimeve në eurozonë, në pajtim me të dhënat përfundimtare, në tetor u konfirmua ulja e normës së inflacionit në eurozonë nga 4,3% në 2,9% në bazë vjetore, kryesisht si pasqyrë e uljes së çmimeve të energjisë.

Njëkohësisht, për shkak të presioneve më të ulëta inflacioniste u përforcuan pritshmëritë e investitorëve se cikli i shtrëngimit të politikës monetare nga FED-i ka përfunduar, ndërkohë në tregjet e instrumenteve derivative u inkorporua ulje totale e normave të interesit prej 25 p.b. deri në qershor të vitit 2024. Në kushte të tilla, normat e kthimit fletëobligacionet shtetërore amerikane janë ulur në të gjithë kurbën e normave të kthimit dhe më të theksuara në segmentin 2, 5 dhe 10 vjeçar të kurbës së normës së

kthimit¹. Lëvizje të tilla u bartën edhe në Eurozonë, ku rënia e normës së kthimit të fletëobligacioneve shtetërore ishte më e moderuar, krahasuar me ShBA-në². Në të njëjtën kohë, optimizmi aktual për uljen e normave të interesit në vitin e ardhshëm shkaktoi rritje të fortë të indekseve botërore të aksioneve. Si rezultat i presioneve më të ulëta inflacioniste, pala valutore EUR/USD u rrit për 2,1% në bazë javore, ndërsa çmimi i arit u rrit për 2% në bazë javore.

Lidhur me përcaktimin e politikës monetare të BQE-së, zëvendëskryetari i BQE-së, Luis de Guindos, paralajmëroi se inflacioni në ekonominë e përbashkët mund të rritet përkohësisht gjatë muajve në vijim, por theksoi se tendenca rënëse do të mbizotërojë ende në afat të mesëm³. Guvernatori i Bankës Qendrore të Francës, Fransoa Villeroy, ka shprehur bindjen se BQE-ja do të arrijë nivelin e qëllimit të inflacionit prej 2% deri në vitin 2025.

Në ShBA, në kundërshtim me perceptimet aktuale të tregut, kryetarja e FED-it të San Franciskos, Meri Dali, paralajmëroi se nuk duhet të miratohen konkluzione të parakohshme në lidhje me procesin e uljes së inflacionit në këtë ekonomi, pavarësisht treguesve inkurajues të inflacionit në periudhën e fundit. Sipas saj, është i nevojshëm parashikim i kujdesshëm i normave të interesit, duke pasur parasysh edhe rreziqet rritëse të çmimeve ekzistuese, sepse në të kundërtën mund të dëmtohet besueshmëria e FED-it.

Në Mbretërinë e Bashkuar, norma e inflacionit dhe inflacioni bazë janë ulur në mënyrë të papritur, përkatësisht nga 6,7% në 4,6% dhe nga 6,1% në 5,7%, në bazë vjetore, kryesisht si rezultat i uljes së çmimeve të energjisë. Treguesit e tillë të çmimeve kontribuan në uljen e presionit ndaj Bankës së Anglisë dhe në përforcimin e pritshmërive të investitorëve se banka qendrore do të nisë uljen e normës referuese të interesit nga qershori i vitit të ardhshëm⁴.

Çmimi i naftës ka vazhduar rënien për të katërtën javë radhazi, kryesisht si reflektim i rritjes së rezervave në ShBA dhe shqetësimit për uljen e kërkesës të këtij energjenti nga ana e Kinës.

Ngjarje të tjera

Në pajtim me parashikimet e fundit të Komisionit European, rritja e parashikuar për vitin 2023 dhe 2024 është rishikuar nga 0,8% në 0,6% dhe nga 1,3% në 1,2%, përkatësisht, duke pasur parasysh inflacionin e lartë, rritjen e normave të interesit dhe kërkesën e dobët të jashtme pati efekt negativ më të theksuar sesa pritej fillimisht. Lidhur me normën e inflacionit, parashikohet që në vitin 2023 të mbetet në të njëjtin nivel, gjegjësisht të arrijë në 5,6% në bazë

¹ Normat e kthimit (yield-et) në segment 2-, 5- dhe 10- vjeçar të kurbës së normës së kthimit në ShBA u ulën për 17, 24 dhe 21 p.b. përkatësisht.

² Normat e kthimit në segment 2-, 5- dhe segment 10-vjeçar të kurbës së normës së kthimit në eurozonë u ulën për 10, 12 dhe 13 p.b., përkatësisht.

³ Sipas tij, burimi më i madh i pasigurisë ende paraqet çmimin e energjentëve, kur ka ende tensione gjeopolitike, me ç'rast edhe çmimet e ushqimeve mund të kenë edhe presion në rritje si reflektim i kushteve të pafavorshme klimatike që vazhdojnë të përkeqësohen.

⁴ Në kushte të tilla, normat e kthimit të letrave shtetërore me vlerë në segment 2vjeçar u ulën rreth 10 p.b., dhe normat e kthimit në segment 5- dhe segment 10-vjeçar u ulën mbi 20 p.b., respektivisht.




BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

RISHIKIM JAVOR I TREGUT 13 – 17 nëntor 2023

vjetore, ndërsa për vitin 2024 pritshmëritë janë rishikuar në rritje nga 2,9% në 3,2% në bazë vjetore.

Treguesit e zgjedhur të tregut



Norma e kthimit në eurozonë

	EUR 6M	EUR 2Y	EUR 5Y	EUR 10Y
30.12.2022	2.10	2.76	2.58	2.57
17.11.2023	3.76	2.96	2.53	2.59
24.11.2023	3.79	3.07	2.62	2.64
ndryshimi javor (p.b.)	3.5	10.8	8.5	5.5
mbledhja e ndryshimit nga fillimi i vitit (p.b.)	168.9	30.8	3.8	7.2

Norma e kthimit në ShBA

	USD 6M	USD 2Y	USD 5Y	USD 10Y
30.12.2022	4.75	4.43	4.00	3.87
17.11.2023	5.43	4.89	4.44	4.44
24.11.2023	5.46	4.95	4.49	4.47
ndryshimi javor (p.b.)	3.8	6.3	4.4	3.1
mbledhja e ndryshimit nga fillimi i vitit (p.b.)	71.1	52.3	48.1	59.2